

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“INVEST STRONG GROUP” -SH.P.K.**

Më datë 14.12.2019 shtetasi:

- 1- **FLAMUR OSMANI**, i biri Veap-it, i datëlindjes 24.11.1984, banues në Belgjik, mbajtës i dokumentit “Pasaporte” me Nr. ES549964;

Ka themeluar shoqërin me përgjegjësi të kufizuar **“INVEST STRONG GROUP” -SH.P.K.**, siaps aktit përkatës së themelimit.  
Ky statute hartohet që të rregullohet veprimtaria e shoqëris **“INVEST STRONG GROUP” -SH.P.K.**

**K R E U I**

**Neni 1**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

- 1.1 Shoqëria **“INVEST STRONG GROUP” -SH.P.K.**, themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në zbatim të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” i ndryshuar.
- 1.2 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.
- 1.3 Kjo shoqëri fiton zotesinë për të vepruar pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë, qëndër e cila pas miratimit të regjistrimit të shoqërisë e pajis atë edhe me NUIS-in përkatës identifikues.

**K R E U II**

**FORMA - EMËRI – SELIA- OBJEKTI – KOHËZGJATIA**

**Neni 2**  
**Forma e shoqërisë**

- 2.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë nuk do të marre një vendim për shëndërrimin e saj nga ortakët:
  - 2- **FLAMUR OSMANI**, i biri Veap-it, i datëlindjes 24.11.1984, banues në Belgjik, mbajtës i dokumentit “Pasaporte” me Nr. ES549964;

**Neni 3**  
**Emërtimi i shoqërisë**

- 3.1 Emërtimi i shoqërisë është **“INVEST STRONG GROUP” -SH.P.K.**

3.2 Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet Sh.p.k.

#### **Neni 4**

##### **Selia e shoqërisë**

- 4.1 Shoqëria e ka selinë në qytetin e **Tiranë, Tirane Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Marko Boçari, Ndertesa Nr.6, Hyrja 1, Dyqani Nr.3, Kati përdhe.**
- 4.2 Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 4.3 Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Ortakut të shoqëris, gjithashtu rast pas rasti ajo mund të krijojë ose anullojë pika dytësore për aktiviteti që po ushtron, brenda ose jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë.

#### **Neni 5**

##### **Objekti i veprimtarisë**

- **Krijim, zhvillim, zyra ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate të veçantë Franchising, aktivitet ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme, agjensi imobiliare;**
- **Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin;**
- **Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale;**
- **Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbeshtetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomik.**
- **Te fitoje dhe te zotëroje, bleje dhe/ose shesë dhe transferojë pasuri të paluajtshme, te drejta mbi pasuri të paluajtshme kur një gjë e tillë është në interes të shoqërisë, dhe në një mënyre të tillë që mund të vendoset rast pas rasti, kryerjen e veprimtarive te tjera dhe hyrje në marrëveshje të tilla të nevojshme të lidhura ose ne ndihmë të sa më sipër;**
- **Të investojë mbi pasuritë e blera, duke ndërtuar infrastukturën, dhe/ose objekte të tjera sipas projektëve të miratuara me qëllim shitje ose me qëllime të tjera konform realizimit të objektit dhe qëllimit të shoqërisë;**
- **Të importojë, eskportoje, blejë, shesë, shpërndajë, tregetojë, të ketë eskuzivitete, komercializojë dhe të kryejë tregti me te gjitha produktet e prodhura me çfarëdolloj metode apo proces, të cilat kanë patentë pse janë**

- të mbrojtura si dhe mallra që duhen për realizimin e ndertimeve apo shoqërive ose nëpërmjete të tretëve;
- Të kryej bashkime, të realizojë pjesmarrje, menaxhojë, supervizojë, të veproje dhe promovojë sipërmarrje, biznesi dhe shoqëri;
  - Të kryejë studime të tregut, të veprojë si konsulent, specialiste tregu, ekspert dhe keshiltar në çfarëdolloj fushe të aktivitetit tregtare, dhe në përgjithësi të angazhohet në projekte kërkimesh dhe projekte zhvillimi aktivitetesh në të gjitha fushat me interes tregtare dhe ekonomike-shoqëror;
  - Të blejë, marrë, japë, me qira, të shkëmbej ose të fitojë nëpërmjet çdo lloj mënyre të ligjshme cdo lloj pasurie të paluajtshme, toke, ndertese, zyre, pajisje, ose cdo pasurie tjetër të luajtshme ose të paluajtshme, dhe cdo lloj të drejte privilegji të lidhur me kete pasuri në përputhje me objektin e shoqërisë ose që mund të konsiderohet i përshtatshëm, dhe kryerjen e përmirësimeve, rikonstruksioni dhe/ose mobilimi në lidhje me pasurin të tilla sic mund të jetë e nevojshme;
  - Të bleje shesë pasuri të paluajtshme për llogari të porositësave, sipas marrëveshjeve së palve; Të veprojë në cilësinë e komisionerit për blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme si dhe të hyjë në marrëdhënje kontraktore që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme, për llogari të të tretëve, përkundrejtë shpërblimit;
  - Të investojë paratë e shoqërisë në cdo mënyre që shoqëria mund të konsiderojë të përshtatshme dhe të vecanta, por jo ekspluzivisht, të fitojë, të blejë dhe të zotërojë pjesë kapitali, aksione, letra me vlerë ose interesa të tjera në shoqëri të tjera, ose në cdo filial që ka objekt të ngjashëm me shoqërin;
  - Të kryejë veprimtari në fushëm e ndërtimit dhe trgtimi/shpërndarja e matrialëve të ndërtimit;
  - Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomik.
  - Shoqëria do të zhvillojë çdo aktivitet tjetër, që çmohet në të mirë dhe në interes të publikut, si shoqata humanitare, dhe që nuk është e ndaluar shprehimisht nga ligji.

## Neni 6

### Kohëzgjatja e shoqërisë

6.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, duke filluar që nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) -Tiranë.

6.2 Me vendim të ortakëve, shoqëria mund vendosë kufizim kohor në veprimtarinë e saj ose ta mbyllë veprimtarinë e saj kur e sheh të arsyeshme, apo jan rastet e parashikuara nga ligj.

### K R E U III

#### KAPITALI THEMELTAR - KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

##### Neni 7

##### Kapitali themeltar

7.1 Kapitali është fiksuar në vlerën 100.000 (njëqind mije) lekë të reja.

7.2 Kapitali ndahet në 1 (një) kuota me vlerë nominale 100.000 (njëqind mije) lekë për kuotë, të numëruara nga 1 (një) deri në numrin e fundit, të shlyera në masën 100% .

7.3 Ortaku zotërues ka kapital në përqindje:

- 1- **FLAMUR OSMANI**, i biri Veap-it, i datëlindjes 24.11.1984, banues në Belgjik, mbajtës i dokumentit “Pasaporte” me Nr. ES549964, mbajtës i 1 (nje) kuote, që përfaqëson 100 % të kapitalit të shoqëris me vlere 100.000 (njëqind mije) leke.

7.4 Kapitali mund të zmadhohet dhe të zvogëlohet me vendim të ortakëve të shoqërisë të cilët ushtrojnë kompetencat e Asamblesë të Përgjithshme.

##### Neni 8

##### Kuotat, fitimi dhe kalimi i tyre

8.1 Kuota e pjesëmarrësit janë në zotërim të:

- 1- **FLAMUR OSMANI**, 1 (një) kuotë të barabarta me 100% të kapitalit.

8.2 Kalimi dhe fitimi i kuotave të shoqërisë do të behët në përputhje me nenet 72-75 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” i ndryshuar.

##### Neni 9

##### Transferimi i kuotave dhe zmadhimi i kapitalit

9.1 Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme edhe në rrugë trashëgimie, apo ndarje pasurore mes bashkëshortëve.

9.1 Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar të ortakut themelues, te persona të tjerë jo ortakë të shoqërisë do të bëhet vetëm me miratimin e Ortakut.

9.2 Ortaku që kërkon të tjetërsoi kuotat e veta ka detyrimin ligjor t’i kominikoj me shkrime ortakut tjetër, duke i treguar bliersin dhe çemimin që bliersia ka ofruar për ti blere.

9.3 Ortaku që çëmon të ushtroj të drejtën e parablerjes, duhet t’i komunikoj me shkrime përgjigjen, ortakut të intresuar brënda nje afati 30 dite, nga data e marrjes së njoftimit të ortakut tjetër. Mungesa e komunikimit me shkrime brënda këtij afati, barazohet me të drejtën e mosushtrimin e të drejtës së parablerjes.

9.4 Ortakët themelues të kësaj shoqërie, mund të vendosin të shtojë kapitalin themeltar të shoqërisë në çdo periudhë që e shohin të nevojshme. Zmadhimi apo zvogëlimi i

kapitalit të shoqërisë do të bëhet sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe nenit 81 të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" i ndryshuar.

## **K R E U I V**

### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 10**

##### **Të drejtat dhe detyrat**

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) Përcaktimin e politikave tregëtare të Shoqërisë;
  - b) Ndryshimet e statutit;
  - c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
  - d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabël të autorizuar;
  - e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d, të kësaj pike;
  - f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët , përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
  - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë të veprimtarisë ;
  - h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
  - j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve ;
  - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
  - l) Krijimin e fondeve, përbërjen, madhësinë, burimet e krijimit, mënyra dhe kushtet e pzdorimit.
  - m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.
- 10.2 Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në regjistrin e vendimeve.

#### **Neni 11**

##### **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.
- 11.2 Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme bëhen sa herë çmohet e nevojshme nga ortakët e shoqërisë.
- 11.3 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët sipas nenit 84 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

#### **Neni 12**

##### **Përfaqësimi në Asamble**

- 12.1 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi perfaqesimi noterial nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

- 12.2 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 13**

#### **Kuorumi**

- 13.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve në kete statut.
- 13.2 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 14**

#### **Marrja e vendimeve**

- 14.1 Me përjashtim të rasteve kur ky statut parashikon një shumicë më të lartë, Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 14.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut ose në ligj për çështjet e tjera, Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 14.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.
- 14.4 Emërimi dhe/ose shkarkimi i administratorëve dhe ekspertit kontabël dhe përcaktimi i shpërblimit të tyre do të bëhet sipas ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" i ndryshuar.
- 14.5 Asambleja e Përgjithshme për çështjet e mëposhtme vendos me votën pro të ortakëve që perfasojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë :
- Miratimi i bilancit.
  - Shpërndarja e dividenteve.
  - Emërimi dhe shkarkimi i personit që do të merret me kontabilitetin e shoqërisë
  - Miratimin i buxhetit vjetor.
  - Autorizimin për nënshkrimin e çfardolloj kontrate.
  - Miratimi i kërkesës për përjashtimin e njërit prej ortakëve .
  - Ndryshimet e statutit.
  - Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit.

- Përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë.
- Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

### **Neni 15** **E drejta e votës**

- 15.1 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- 15.2 Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimi, përfshirë mjetet elektronike.
- 15.3 Mjetet elektronike të lejuara janë:
- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
  - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
  - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
- 15.4 Përdorimi i ketyre mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e tyre dhe sigurinë e komunikimeve elektronike.
- 15.5 Ortakët kanë të drejtën, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që marrëveshja të bëhet me shkrim.

### **Neni 16** **Përrjashtimi nga e drejta e votës**

- 16.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 16.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 17** **Proçesverbalet e mbledhjes së Asamblesë**

- 17.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në proçesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të ketyre proçesverbaleve.
- 17.2 Proçesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe mbajtësit të proçesverbalit, rezultatet e votimit.
- 17.3 Proçesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

17.4 Proçesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i proçesverbalit.

## **Neni 18**

### **Hetimet e posaçme**

- 18.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregëtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.
- 18.2 Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e shoqërisë, dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga Asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
- 18.3 Kur Asambleja e Përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortaku ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.

## **Neni 19**

### **Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshperblimi**

- 19.1 Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorit kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.
- 19.2 Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në Asamblenë e shoqërisë, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.
- 19.3 Në rastet kur shoqëria ngre padi për rastin e mesipërm përfaqësuesi i posaçëm, me anë të të cilit do të marrë pjesë në gjykim, do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme.
- 19.4 Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se ai mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.
- 19.5 Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të





vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara.

- 19.6 Ortakët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat (19.2 e 19.4) të këtij neni, edhe në rastin kur Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre ndaj administratorëve për ngritjen e padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

## **Neni 20**

### **Të drejtat e lidhura me kuotën**

- 20.1 Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave.

## **K R E U V**

### **ADMINISTRATORI**

## **Neni 21**

### **Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet**

- 21.1 Ortaku i vetëm apo Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë riemerimi. Emërimi i administratorit jep efekte ligjore vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 21.2 Administratori i një shoqërie tregëtare mëmë, nuk mund të emërohen si administrator i kësaj shoqërie.
- 21.3 Administratori detyrohen të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregëtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm që ushtron detyrat e Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
  - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë,



- siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.
- 21.4 Në rastet e parashikuara nga statuti dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj, administratori është i detyruar të paraqesë raport të ortaku e shoqërisë apo të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rast se do të ketë shtim të ortakëve të shoqërisë.
- 21.5 Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 21.6 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
- 21.7 Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 21.8 Administrator e shoqërisë është **z. FLAMUR OSMANI** me afat emërimi për 5 vjet me të drejtë riemërimi.

## Neni 22

### Përfaqësimi

- 22.1 Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta.
- 22.2 Administratori mund të nënshkruajë kontrata vetëm pasi të jenë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.

## Neni 23

### Shpërblimi

- 23.1 Shpërblimi bazë i administratorit mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme.
- 23.2 Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
- 23.3 Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.
- 23.4 Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

## Neni 24

### Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

- 24.1 Administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;



- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të statutit dhe ligjit.
  - dh) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshëm.
- 24.2 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 24.3 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.
- 24.4 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ketij statuti kryejë veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse për të shlyer detyrimet;
  - d) jepi kredi.

## K R E U V I

### PUNËSIMI NË SHOQËRI

#### Neni 25

##### Zbatimi i legjislacionit të punës

- 25.1 Për ushtrimin e veprimtarisë së saj shoqëria ka të drejtë të marrë në punë punonjës, punësimi i të cilëve bëhet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin e punës të Republikës të Shqipërisë, në këtë statut dhe në kontratën përkatëse të punësimit.
- 25.2 Shoqëria ka detyrimin tu garantojë punëmarrësve kushte punë të përshtatshme, sipas kërkesës të vendit të punës, mjete të nevojshme për realizimin e detyrave, si dhe përfitimet e tjera që u garantohen prej ligjit.

**Neni 26**  
**Disiplina në punë**

- 26.1 Punëmarrësi ka për detyrë të respektojë disiplinën në punë gjatë kohëzgjatjes të punës ose në lidhje me të.
- 26.2 Ortakët/Asambleja ka të drejtë të hartojë për këtë qëllim rregulloren e brendshme të punës, e cila duhet të respektohet me përpikmëri nga të dy palët. Punëmarrësi përgjigjet për dëmet që i shkakton shoqërisë me faj gjatë punës.
- 26.3 Emerim/ shkarkimi i stafit të shoqëris dhe caktimi i pages se tyre përcaktohet me vendim asambleje.
- 26.4 Pezullimi nga puna mund te behet me vendim të administratortit deri në marjen e një vendimi përfundimtar nga asambleja e ortakve.
- 26.5 Të gjithë personat që do të punësohen në shoqëri, jan të detyruar të ruajn sekretin tregtar dhe të mos u japin informacion konkurrenteve në treg, lidhur me të dhënat që ndikojn në rritjen e aktivitetit tregtare të shoqëris.

**K R E U VII**

**VITI FINACIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT**

**Neni 27**  
**Viti financiar, llogarite vjetore**

- 27.1 Viti financiar fillon nga data 1 janar deri në 30 dhjetore.
- 27.2 Në çdo vite financiar shoqëria bënë llogaritjen e llogarive vjetore, inventarin, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuar nga administratori dhe nga eksperti kontabël i autorizuar/ mirtatuar me vendim asambleje.
- 27.3 Miratimi i llogarive vjetore behet me 3/4 te kuotave të ortakve, brnada 6 muajve të vitit pasardhës.

**Neni 28**  
**Ndarja e fitimit**

- 28.1 Shoqëria nga vitit financiar, do të shpërndaj për ortakët dividendin, ku këtu jan zbritur shpenzimet vjetore.
- 28.2 Shoqëria nga fitimi që ka rezervuar nga viti financiar, duke zbritur humbjet e shkatuara nga viti i mëparshëm, lë mënjane një shume derin 1/10 e vlerës së humbjes që është shkaktur nga viti i mëparshëm. Kjo shumë e lënë mënjane do të shërbej si rezerve e domozdoshme.
- 28.3 Vendimi për përdorimi e çdo fondi që është lënë si rezerv e domozdoshme përdoret vetëm me vendim të mar nga asambleja e ortakve.



## K R E U VI

### PRISHJA E SHOQËRISË

#### Neni 29

#### Shkaqet e prishjes së shoqërisë

29.1 Kjo shoqëri prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në këtë statut;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme/ Ortakve të shoqërisë;
- c) kur nuk mund të realizohet objekti i Shoqërisë i parashikuar në statut;
- ç) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregëtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”; me vendim të gjykatës;

29.2 Shoqëria nuk prishet kur njëri nga ortakët falimenton, bëhet i paaftë ose vdes.

#### Neni 30

#### Shndërrimi i shoqërisë

30.1 Shoqëria mund të shndërrohet në shoqëri kolektive, komandite ose anonime vetëm me vendim të Asamblesë të Përgjithshme të Ortakve të shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.


#### Neni 31

#### Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese

- 31.1 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas parashikime të ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” i ndryshuar.
- 31.2 Për kryerjen e procesit të likuidimit, Ortakët e shoqërisë/ Asambleja e Përgjithshme emëron likuiduesin i cili paraqet një raport mbi gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e përfundimit të tyre.
- 31.3 Mbas pagimit të kreditorëve, likuiduesi ndan aktivitetin e mbetura, ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin regjistruar.
- 31.4 Më përfundimin e procesit të likuidimit ortakët e shoqërisë bëjnë bilancin financiar përfundimtar, për rregullshmërinë e likuiduesit, për heqjen e mandatit të tij si likuidator, si dhe për mbylljen e procesit të likuidimit.

## K R E U VII

### LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE



## Neni 32

### Largimi i ortakut për shkaqe të arsyeshme

- 32.1 Ortaku mund të largohen nga shoqëria nëse ortakut tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
- 32.2 Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.
- 32.3 Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
- 32.4 Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
- 32.5 Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.
- 32.6 Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

## Neni 33

### Përrjashtimi i ortakut

- 33.1 Asambleja e Përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përrjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përrjashtim.
- 33.2 Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përrjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, rastet kur ortakut:
  - a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
  - b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
  - c) përrfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;
  - ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
- 33.3 Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përrjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përrjashtimin.
- 33.4 Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përrjashtim nuk është e bazuar.

33.5 Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

#### **Neni 34**

##### **Pasojat e largimit dhe përjashtimit**

34.1 Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

### **K R E U VIII**

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **Neni 35**

##### **Mosmarrëveshjet**

35.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit ndërmjet ortakëve, ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë, do të zgjidhet me mirkuptim dhe kur nuk harrihet kjo do të zgjidhet në rrugë gjyqësore.

35.2 Çështjet që nuk trajtohen në këtë statut, rregullohen nga legjislacioni tregëtar shqiptar në fuqi.

**Ky statute u hartua në 2 (dy) kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe u nënshkruhu sot më datë 14.12.2019, nga Ortaku themelues i shoqërisë:**

1- FLAMUR OSMANI  
**Z. FLAMUR OSMANI**

